

SHQIPËRIA DHE INTEGRIMI

Ermelinda Meksi
Ministre e Bashkëpunimit Ekonomik dhe
Tregtisë

Një dekadë më parë, Shqipëria dhe populli shqiptar vendosi të sfidonte historinë e tij shumëshekullore të ndarjes dhe izolimit nga Europa, të cilës deri atëherë i përkiste thujse vetëm gjeografikisht.

Dhjetë vjet më parë, busulla e jetës politike shqiptare ndërronte kursin e shigjetës me 180 gradë. Në një rën anë "e duam

Shqipërinë si gjithë Europa", ishte shprehja që pushtoi politikën zyrtare, aspiratat dhe vullnetin e njerëzve, dhe, në anën tjetër, një pjesë e shqiptarëve, të pamësuar me "lirinë e munguar", nën euforinë "terapike" të ndryshimeve, shkatërronin me shpresë se dikush do t'i ndërtonte më mirë.

Realiteti shqiptar nuk ka qenë ndonjëherë më i mbarsur dhe më i brishtë, se në atë periudhë, kur aseti më i madh që kishim, ishte shpresa dhe vitaliteti i një populli të vuajtur, e të stërvitur tashmë të mbijetojë. Më kujtohet një kronikë televizive e një mbrëmjeje fillimi vere të vitit 1991.

Në Tiranë, mbushej sheshi "Skënderbej", si asnjëherë tjetër, nga njerëz që brohorisnin të ekzaltuar ardhjen e Sekretarit të Shtetit Amerikan në Shqipëri, ndërsa në lajmin pasardhës thuhej që në Portin e Durrësit filloi shkarkimi i kamionëve të parë, që mbartin ndihma ushqimore nga Bashkimi Europian.

Përfaqësuesit e Qeverisë Italiane ishin në Tiranë për fillimin e operacionit të shpërndarjes së ndihmave ushqimore "Pelikan", ndërsa në një shkollë malore po shpërndaheshin ndihmat e para ushqimore për fëmijët.

Dhjetë vjet më parë dinim se për ku aspironim të shkonim, por nuk ishim të ndërgjeshëm për kohën dhe koston që na duhej për të shkuar atje.

Dhjetë vjet më vonë, jemi larguar në mënyrë galopante nga realiteti cilësor dhe sasi i viteve të para '90-ës, kemi mësuar shumë, kemi rritur ndërgjegjësimin për dimensionet e potencialet e vërteta të Shqipërisë, kemi sofistikuar objektivat tanë, dimë se çfarë duhet të bëjmë për të shkuar atje, por mbetemi përsëri me dilemën "se sa kohë do të na duhet për ta bërë Shqipërinë si gjithë Europa".

Në mënyrë të përmbledhur po përshkruaj spektrin e marrëdhënieve Shqipëri - Bashkimi Europian, në këta dhjetë vjetët e fundit.

Që prej vitit 1991 Shqipëria ka përfituar nga asistenca e BE-së rreth 1 miliardë e 50 milionë euro. Nga të cilat, rreth 85 milionë janë kredi nga Banka Europiane e Investimeve dhe pjesa tjetër, grant. Midis viteve 1991 - 1993, rreth 318 milionë euro ju ofruan Shqipërisë si ndihma emergjence dhe ushqimore. Nga viti 1994-1996, programi Phare ka ofruar rreth 190 milionë euro, si mbështetje për reformat ekonomike. Mbas krizës së vitit 1997,

prioritetet e asistencës komunitare u reduktuan duke u fokusuar më shumë në masat për rivendosjen e shtetit ligjor, në mbështetje të fushave si administrata publike, policia, doganat, drejtësia, dhe në një masë më të reduktuar vazhdoi mbështetja për infrastrukturën si transporti dhe furnizimi me ujë. Programi CARDS 2001, që ofron rreth 37,5 milionë euro, do të fokusohet në prioritetet e Stabilizim Asocimit.

Aktualisht, marrëdhëniet kontraktuale midis Shqipërisë dhe BE-së bazohen në marrëveshjen jopreferenciale të tregtisë dhe të bashkëpunimit ekonomik, në fuqi që prej dhjetorit të vitit 1992. Që prej tetorit të vitit 1999, Komuniteti i ofroi Shqipërisë, mbi baza autonome, koncensione të tjera tregtare duke hequr taksat për shumicën e eksporteve shqiptare. Koncensionet tregtare u përmirësuan më tej nga një paketë tjetër preferencash tregtare të ofruara ndaj Shqipërisë nga BE-ja, në shtator të vitit 2000.

Në aspektin politik, në fillim të vitit 1995, Shqipëria kërkoi zyrtarisht hapjen e bisedimeve për një marrëveshje asociimi me BE-në. Një vlerësim i ndërmarrë nga Komisioni i BE-së, mbi mundësitë e tregtimit të lirë të mallrave, të shërbimeve e kapitaleve në Shqipëri, konkludoi se një Marrëveshje Europiane "klasike" e tipit të marrëveshjes që gëzojnë vendet që sot janë në negociata për anëtarësim në BE, do të ishte hap i parakohshëm për Shqipërinë. Këshilli i Ministrave të BE-së, i janarit 1996, i kërkoi Komisionit Europian të përgatiste një propozim për një marrëveshje të re që do të përforconte raportet e Shqipërisë me BE-në, por që nuk do të ishte në nivelin e Marrëveshjes Europiane. Por, zgjedhjet parlamentare të majit të vitit 1996, vunë një pikëpyetje mbi demokracinë në Shqipëri. Një vit më vonë, ngjarjet dhe kriza e vitit 1997 vunë "*status quo*-në" në marrëdhëniet kontraktuale midis Shqipërisë dhe Bashkimit Europian.

Në nëntor të vitit 1999, Komisioni Europian i prezantoi këshillit një raport mbi fizibilitetin e hapjes së bisedimeve për Stabilizim Asociimin me Shqipërinë, i cili konkludonte se parakushtet për hapjen e këtyre negociatave nuk ishin plotësuar akoma.

Në Samitin e Zagrebit, në nëntor të vitit 2000, u vendos për ngritjen e Grupit të Përbashkët të Nivelit të Lartë midis Shqipërisë dhe BE-së, që do të vlerësonte progresin e bërë në kuadër të reformave në Shqipëri. Bazuar në rekomandimet e këtij Grupi, Komisioni Europian, i propozoi Këshillit, në qershor, hapjen e negociatave me Shqipërinë për Marrëveshjen e Asociimit Stabilizimit. Po në qershor, Këshilli ju përgjigj pozitivisht këtij propozimi të Komisionit.

CILËT JANË OBJEKTIVAT TANË DHE ÇFARË DUAM TË BËJMË KONKRETISHT NË KUADËR TË STABILIZIM ASOCIMIT ?

Mendoj se kjo mund të shprehet thjesht: objektivi ynë është të *transformojmë* Shqipërinë. Të mundësojmë arritjen në këtë vend, të një demokracie të qëndrueshme, që në themel të ketë institucione të forta dhe pushtetin e ligjit, të mbështetura nga një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik mbi bazën e konkurrencës së lirë dhe parimeve të ekonomisë së tregut.

Shpresa dhe qëllimi ynë është që fëmijët, që sot ndjekin klasat fillore në Shqipëri, kur t'u vijë koha të mbarojnë studimet, të kenë mundësi të jetojnë në një vend - në vendin e tyre - që ka ndryshuar radikalisht për mirë, në prosperitet ekonomik e social, në një demokraci europiane të qëndrueshme, në paqe me veten dhe me të tjerët, në një vend që deri atëherë ose të jetë bërë anëtar i BE-së ose mund të jetë fare pranë këtij realiteti.

Ky është një objektivi i vizionit sublim, që realisht do të kërkojë kohë dhe shumë përpjekje për t'u bërë realitet. Ju desh vendeve aktuale anëtare të BE-së gati një gjysmë shekulli për të arritur shkallën e integritetit që gëzojnë sot nën ombrellën e Bashkimit Europian. Do t'ju duhet mbi pesëmbëdhjetë vjet nga rënia e murit të Berlinit, vendeve të para të Europës Qendrore e Lindore si Polonia, Hungaria, Çekia apo ndonjë tjetër për t'u anëtarësuar në BE. Por, nuk duhet të kalojë shumë kohë mbas kësaj që edhe Shqipërisë t'i ofrohet apo ta fitojë këtë shans.

Liderët europianë, kanë deklaruar se, politikisht të gjitha vendeve të Europës Qendrore e Lindore, përfshirë edhe Ballkanin, ju ofrohet perspektiva e hyrjes në familjen e madhe europiane, pavarësisht nga niveli i zhvillimit aktual. Por, diferenca midis tyre është sa kohë do t'i duhet gjithësecilit për të merituar hyrjen në BE.

SA LARG KEMI SHKUAR DERI TANI ?

Shqipëria ka hyrë në një rrugë që nuk ka kthim mbrapa. Procesi i tranzicionit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi klasike tregu, tregoi që është një proces që ka dy tipare kryesore: *proces i gjatë* dhe *proces gradual*.

Procesi i reformave në Shqipëri filloi në kushtet e një *vakumi institucional*. Reformat e fillimit të viteve '90, që u fokusuan në liberalizimin dhe privatizimin, të kryera në mënyrë radikale, pa

ngritur më parë institucionet dhe kulturën e nevojshme të tregut, shkaktuan konfuzion dhe rënie, në të kundërt të rritjes ekonomike. Fokusi kryesor i politikave ekonomike në dekadën e fundit ka qenë më shumë në ruajtjen e treguesve fiskalë si inflacioni apo qëndrueshmëria e çmimeve, se sa në rritjen ekonomike.

Megjithatë, nisur nga situata makroekonomike e vitit 2001, si dhe duke patur parasysh tendencën pozitive të të gjithë indikatorëve ekonomikë të periudhës së paskrizës së vitit 1997, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm duke shënuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në nivelin 7 për qind, e cila është arritur edhe nëpërmjet sigurimit dhe konsistencës dhe të qëndrueshmërisë të të gjithë treguesve makroekonomikë.

Dhjetë vjet janë një kohë relativisht e shkurtër për të transformuar e ndërtuar gjithçka.

Të gjithë jemi dëshmitarë të spirales së zhvillimit të shoqërisë shqiptare në këta dhjetë vjetët e fundit. Shumica e qeverive në pushtet, nuk e kanë pasur "luksin" për të zbatuar politika afatgjata zhvillimi. Kjo për dy arsye, e para, ciklimi i krizave politike e sociale në vend dhe e dyta, nevoja për rimëkëmbje përpara futjes në fazën e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Përvoja e vitit '97, tregoi se sa lehtë një vend si Shqipëria mund të rrëshkasë nga rruga e reformave, dhe se si frutet e mudi i një pune shumëvjeçare mund të shkojnë dëm, kur interesat afatshkurtër të një grupi politik bëhen dominuese apo kthehen në politika populiste. Sinqerisht shpresoj që politika shqiptare të mos përsërisë gabime me kosto të tilla.

Sidoqoftë, fizionomia e shoqërisë dhe e ekonomisë shqiptare po ndryshon drejt kahut pozitiv. Fatmirësisht, Shqipëria ashtu si dhe një pjesë e mirë e vendeve të rajonit, po del nga faza e tranzicionit të mirëfilltë. E ardhmja e Shqipërisë mbështetet në pjesëmarrjen tonë në organizata ndërkombëtare politike dhe ekonomike.

Anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë, përveç se rikonfirmoi faktin që Shqipëria është një vend serioz, që kërkon integrimin në të gjitha strukturat europiane dhe euro-atlantike, ka ofruar tashmë një eksperiencë të vyer në kuadrin e negocimit ndërkombëtar.

Në hartimin e politikave në funksion të këtij anëtarësimi, është synuar të koordinohen elemente të politikave sektoriale të fushave të ndryshme të ekonomisë sonë, interesat buxhetorë dhe respektimi i marrëveshjeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe të gjitha parimeve të Organizatës Botërore të Tregtisë, pa krijuar deformime ekonomike e financiare të momentit e duke i shërbyer, në të njëjtën kohë, politikave të brendshme në terma afatmesëm.

Ky proces u kurorëzua me sukses për faktin se funksionoi në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Negocimit me vendet anëtare të Organizatës Botërore të Tregtisë, ku pati një koordinim eficient të:

- interesave të brendshëm nëpërmjet hartimit të politikave sektoriale të fushave të ndryshme të ekonomisë;
- interesave buxhetorë; si dhe
- gjithë detyrimeve që Shqipërisë i rrjedhin në kuadrin e marrëveshjeve apo të organizmave ndërkombëtarë ku aderon.

Zbatimi i kësaj strategjie, si një hap serioz i hartimit të politikave të brendshme në terma afatmesëm, pati një impakt direkt në disiplinimin e marrëdhënieve tregtare, si dhe kontribuoi duke shërbyer në konsolidimin e një mjedisi atraktiv të vendit ndaj investitorëve të huaj.

Në këtë kontekst, Shqipëria është prezantuar gjatë këtyre negociatave me një skedul në fushën e shërbimeve, me një skedul në fushën e bujqësisë, me një paketë të legjislacionit aktual, një sërë amendimesh të ligjeve apo akte të reja ligjore e nënligjore, që në vetvete përfaqësojnë përmirësime të dukshme reformuese; kemi paraqitur, gjithashtu, një numër të konsiderueshëm memorandumesh: si memorandumi në Fushën e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale, që lidhet me tregtinë, ai i Prokurimit Publik, memorandumi i Licencimeve në Eksporte dhe Importe, ai i masave Sanitare e Fitosanitare, memorandumi i Barrierave Teknike në Tregti, memorandumi i Masave për Investimet në Tregti etj.. Për hartimin e këtyre të fundit u desh të ndërmerrej një reformë radikale për plotësimin e kuadrit ligjor dhe sjelljen e tij në nivele të standardeve ndërkombëtare, duke u shkëputur përfundimisht nga forma kaotike dhe duke krijuar një paketë të disiplinuar, dhe transparente në përputhje me rregullat dhe parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë. Pjesa më e madhe e kësaj pakete është ndërmarrë vetëm gjatë periudhës mars-nëntor 1999.

E gjithë kjo punë e vështirë tregoi që në Shqipëri është e mundur të ndërmerren reforma ekonomike të suksesshme me impakte të dukshme, ndonëse në një segment të shkurtër kohor.

- Hartimi i formës përfundimtare të ofertës së re të tarifave detyruese për hyrjen në tregun shqiptar të mallrave sipas modelit tip të Organizatës Botërore të Tregtisë;
- Përgatitja e skedulit të shërbimeve.
- Rishqyrtimi i afateve të liberalizimit të tarifave për grupmallrat, të cilët bëjnë pjesë në marrëveshjet sektoriale të parashikuara nga Organizata Botërore e Tregtisë, duke synuar shkurtimin e tyre.
- Hartimi dhe avancimi në procesin e miratimit të një pakete tejet ambicioze prej 66 aktesh ligjore e nënligjore, kryesisht në lidhje me përmirësime në ligjin "Për akcizat", ligjin "Antidumping", ligjin për "Mbrojtjen e Topografive të qarqeve të integruara", në vendimin e Këshillit të Ministrave për "Dispozitat zbatuese të kodit doganor", miratimin në parim të marrëveshjeve të Organizatës Botërore të Tregtisë për "Rregullat e origjinës", "Licencimet në importe", "Masat sanitare e fitosanitare", në ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit mbi "Pronësinë intelektuale"; në ligjin "Për kompanitë e sigurimit dhe risigurimit", në ligjin "Për standardizimin", në mbështetje të këtij të fundit janë miratuar gjithashtu, nga Këshilli i Ministrave katër vendime dhe një urdhër i kryeministrit.
- Realizimi i përmirësimeve në shërbimin e auditimit dhe të atij kontabël me synim liberalizimin e tij.
- Miratimi nga Këshilli i Ministrave i Dokumentit të Politikave për Privatizimin dhe Liberalizimin e shërbimit të Telekomit etj..

Ne duhet të kuptojmë - dhe gjithashtu të ndërgjegjësojmë edhe qytetarët e këtij vendi - kohën që procesi i tranzicionit do të marrë realisht - dhe se progresi, qoftë edhe i ngadalshëm, nuk do të thotë stagnacion. Çfarë kemi bërë është vetëm fraksion i asaj se çfarë duhet të bëjmë.

ÇFARË OFRON PROCESI I ASOCIM STABILIZIMIT ?

Në qoftë se do të pyesnim në mënyrë spontane qytetarët e thjeshtë se "cili është perceptimi i tyre për Bashkimin Europian dhe Institucionet Europiane", jam e bindur se shumica e tyre do ta identifikonin Bashkimin Europian me fjalët stabilitet, rend, papunësi e ulët, nivel i konsiderueshëm jetese, funksionim i ligjeve të një demokracie të hapur, institucione publike të besueshme në shërbim të qytetarëve, të dominuara nga transparenca dhe jo nga korrupsioni, të drejtat e individit të garantuara nga ligji dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Me një imazh për Bashkimin Europian

ndoshta edhe më të avancuar se realiteti, të gjithë do të aspironin që Shqipëria të ishte pjesë e saj.

Po ç'është në të vërtetë marrëveshja e Stabilizim Asocimit ? Po t'i hedhësh një sy të vetmes marrëveshje asociimi në fuqi për momentin, asaj midis Bashkimit Europian dhe Maqedonisë, të jep përshtypjen se është një dokument i thjeshtë, që simbolizon një marrëdhënie kontraktuale midis një modeli të përparuar si Bashkimi Europian dhe një vendi në tranzicion. Marrëveshja në vetvete nuk ka "formula magjike". Në realitet, i gjithë procesi për përgatitjen, negocimin dhe implementimin e saj konstituon një mekanizëm të fuqishëm për ndryshime dhe zhvillim.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ofron një dinamikë të veçantë në marrëdhënie me Bashkimin Europian, që do t'i ndihmojë vendet e Ballkanit për të transformuar e përmirësuar sistemin e qeverisjes. E thënë në mënyrë figurative, ngritjen e një "software" institucional që do të rriste aftësitë e shtetit për t'i ofruar qytetarëve të tij stabilitetin e dëshiruar e shpesh të munguar, të mundësojë zhvillimin e një ekonomie të bazuar në parimet e tregut të lirë, që do të gjenerojë rritjen e mirëqenies materiale, që hap pas hapi të përgatisë vendin për anëtarësi në Bashkimin Europian.

Marrëveshja e Asocimit dhe asistencë e Bashkimit Europian për vendet e Ballkanit synon, gjithashtu, krijimin e një zone atraktive për tërheqjen e investimeve të huaja, për promovimin e marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Europian dhe me vetë rajonin, krijimin e strukturave të qëndrueshme që nga shërbimi civil deri tek policia, nga bankat qendrore deri tek shërbimet për administrimin e kufijve e emigracionit, krijimin e një media të civilizuar e të pavarur, që prek dhe mbron ndjenjat dhe besimin e çdo qytetari, dhe jo vetëm të atyre që qëlluan të jenë në krahun e mazhorancës politike apo etnike.

Por, si çdo kontratë tjetër që ka më shumë se një palë, edhe në këtë rast janë dy partnerë. Në njërin anë Bashkimin Europian ofron modelin, rrugën, asistencën e mekanizmin që duhet ndjekur - dhe në anën tjetër vendi partner duhet të demonstrojë, në mënyrë ekuivoqe, që vërtetë ndan me Bashkimin Europian parametra të krahasueshëm në vlerat e dimensionet themelore politike, standardin ekonomik dhe nivelin e respektimit të të drejtave të individit dhe shoqërisë. Si ekuivoku politik dhe ai ekonomik e social janë procese që duan kohën dhe hapësirën e tyre.

Siç e përmenda edhe më sipër, thelbi dhe synimi kryesor i Procesit të Stabilizim Asocimit, është forcimi i institucioneve. Dobësia e institucioneve nuk duket se është vetëm specifike shqiptare, por e përbashkëta e të gjitha vendeve të rajonit tonë, ku historia nuk ka lejuar që demokracia dhe shteti ligjor të hedhin rrënjë solide. Shumë perandori e pushtues fizikë e ideologjikë kanë ardhur e shkuar; shumë qeveri janë ngritur e kanë rënë; por parametrat demokratikë - dhe mbi të gjitha pushteti ligjor - kanë ngelur të brishtë.

Në këtë aspekt, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit është një axhendë praktike e objektivave dhe e parametrave që duhen ndryshuar. Marrëveshja e asocimit është udhëzuesi i procesit të ndryshimeve, por nuk është kjo marrëveshje që sjell ndryshimet. Cilado qoftë sasia apo cilësia e asistencës së ofruar, ajo nuk mund të jetë "shkopi magjik" i ndryshimeve. Rezultatet e vërteta, sukcesi apo dështimi, varen nga vullneti i vetë vendit për të ndryshuar dhe serioziteti, angazhimi i sinqertë i politikës dhe i qeverisjes së tij. Deklaratat politike, strategjitë e shkruara, kanë pa dyshim rëndësinë e tyre në përcaktimin e vizibilitetit të asaj se ku duhet të shkojmë dhe çfarë duhet të bëjmë për të shkuar atje. Por, realisht, nuk janë të mjaftueshme. Angazhimi real për t'i zbatuar është çfarë Bashkimi Europian pret dhe ka si kusht të partneritetit në këtë ndërmarrje të përbashkët. "Kondicionaliteti" është një nga elementet bazë të procesit të Stabilizim Asocimit dhe të marrëveshjes përkatëse. Mesazhi i Bashkimit Europian është i qartë, për aq kohë sa vendi partner nuk është realisht gati të plotësojë kondicionalitetin e marrëveshjes, nxitimi është i dëmshëm për procesin. Në qoftë se, reformë do të thotë shumë përpjekje dhe ndoshta edhe sakrificë, atëherë kjo është rruga e vetme që duhet të ndjekim. Vendi zhvillohet vetëm nëse qytetarët dhe liderët e tij punojnë për zhvillimin. Ndoshta, eksperiencia dhe argumentet politike që shpejtuan përfundimin e kësaj marrëveshjeje me Maqedoninë ishin një rast nga i cili mund të nxirren mësim.

Nevoja për institucione të forta e efikase dhe kapacitete të zhvilluara me një mentalitet progresiv, është thelbësore për procesin. Një vendi si Shqipëria nuk i mungojnë talentet dhe kapacitetet njerëzore. Por, historikisht, inteligjenca në Shqipëri i ka ngjarë trurit hiperaktiv të një dinosauri, që lufton për të mobilizuar trupin e një burokracie inerte. Ndaj, edhe institucionet janë fokusi kryesor dhe thelbi i progresit në procesin e Stabilizim Asocimit. Adoptimi i legjislacionit europian është primar në proces. Së pari, duhet të ndërtojmë institucione e një administratë të aftë për të

harmonizuar legjislacionin e vendit me atë komunitar, e paralelisht zbatimin efektiv të tij, si kushti themelor i integritetit evropian. Por, dëshira e mirë dhe fotokopjimi i legjislacionit evropian nuk janë të mjaftueshme për të shkuar shumë larg. Ligjet duhet të kuptohen, të pranohen e të zbatohen.

Ekuvokut ekonomik i zhvillimit, do gjithashtu, kohën e tij. Vendet e Ballkanit, Shqipëria ndoshta më shumë se të tjerat, do të duhet të punojnë shumë për të ngritur një ekonomi tregu solide dhe të aftë për të konkurruar në mënyrë të hapur me vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Asistenca e Bashkimit Evropian në procesin e Stabilizimit Asociativ në fushën ekonomike do të fokusohet në masat që do të mundësojnë transformimin e ekonomisë shqiptare nga një sistem i dominuar prej sektorit publik në një sistem të udhëhequr nga sektori privat si gjenerator kryesor i rritjes ekonomike. Aspektet kryesore që ndihmojnë apo pengojnë zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri mund të përmbliken në (i) kultura akoma në zhvillim e biznesit privat (ii) mungesa e një strukture biznesi eficiente (iii) funksionimi jo i rregullt i mekanizmave të tregut të lirë, si konkurrenca, licencimet etj. (iii) mungesa e partneriteteve publike-privat në promovimin e investimeve (iv) mungesa e një sistemi të zhvilluar bankar aktiv në kreditimin e biznesit (v) mungesa e stabilitetit afatgjatë në vend e në rajon. Por, derisa sektori privat të mund të luajë një rol në këtë drejtim, ekonomia shqiptare, sidomos në drejtim të investimeve kapitale - kryesisht ato infrastrukturore, do të vazhdojë të mbetet e varur nga financimet e huaja.

Me këtë rast, do të doja të sillja në vëmendje të audiencës, sidomos të kolegëve të mi anëtarë të Qeverisë, një kontradiktë "virtuale" midis kërkesave globale të procesit të Stabilizimit Asociativ e zhvillimit global të Shqipërisë - dhe asistencës së Bashkimit Evropian nën programin CARDS, të parashikuar për periudhën në vazhdim. Siç dihet, Bashkimi Evropian ka qenë donatori kryesor për Shqipërinë. Ndryshe nga dhjetë vjetët e fundit, asistenca e Bashkimit Evropian për periudhën 2002 - 2006 do të përqendrohet kryesisht në sektorët "soft" të zhvillimit, duke e vënë fokusin në reformimin dhe në zhvillimin institucional, në harmonizimin e legjislacionit, në mbështetjen për reformat dhe zhvillimin e policisë, administrimin e kufijve, doganat, tatimet, konkurrencën, mbrojtjen e konsumatorit e në sektorë të tjerë të ngjashëm me sa më sipër. Siç shihet, pak mund të presim nga Bashkimi Evropian për periudhën në vazhdim, të mbështesë sektorët e ekonomisë reale që kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike. Në qoftë se

asistenca e Bashkimit European për zhvillimin institucional nuk do të bashkërendohet me burime nga donatorë të tjerë apo nga buxheti i shtetit, për financime në sektorët realë të ekonomisë, sukcesi i këtij procesi dhe i përpjekjeve tona do të ishte i mangët. Në këtë stad që ndodhet Shqipëria, sidomos investimet në infrastrukturë janë vitale. Rritja ekonomike mbetet baza e zhvillimit dhe e potencialit të një vendi. Po të konsiderojmë nivelin e të ardhurave për frymë që kanë sot vendet kandidatë për t'u bërë anëtare të Bashkimit European si për shembull, sipas shifrave të vitit 2000, Sllovenia 10.700 \$, Çekia 4.924 \$, Hungaria 4.740 \$, Polonia 4.200 \$, është e qartë që Shqipërisë i ngelet shumë për të bërë në këtë drejtim.

DIMENSIONI RAJONAL I INTEGRIMIT

Kur flasim për Stabilizim Asocimin, nuk mund të lëmë pa përmendur Paktin e Stabilitetit dhe integrimin rajonal, si proces komplementar i integritit europian. Ndryshe nga çfarë u ka servirur historia shumëshekullore, në këtë fillim shekulli, vendet e Ballkanit kanë fatin e patjetërsueshëm të jenë pasagjerë të të njëjtit tren - edhe pse mund të kenë hipur në stacione të ndryshme. Destinacionin e kanë të përbashkët - edhe pse kostoja e biletës mund të mos jetë e njëjtë. Bashkimi European, gjithmonë e më shumë në strategjinë e tij, po promovon një trajtim global të rajonit. Aksioni për integrimin e vendeve të rajonit me njëri-tjetrin, si hap i parë drejt integritit europian, ka marrë tashmë përmasa galopante në kuadër të iniciativave të Paktit të Stabilitetit. Pakti i Stabilitetit është pa dyshim nisma më e rëndësishme për rajonin që ka meritën historike që ka *strukturuar partneritetin* politik dhe ekonomik, duke i dhënë një fokus rajonal politikave dhe strategjive të zhvillimit të vendeve të rajonit. Është një shans që i jepet Ballkanit për të shndërruar diversitetin historik, në sfida të përbashkëta zhvillimi drejt një të ardhmeje më të mirë. Është, për herë të parë, që vendet e rajonit ulen në tryeza politike dhe ekonomike në mënyrë të konsoliduar, të vijueshme e pa paragjykime. Është për herë të parë që diskutohen politika, strategji, programe e projekte të përbashkëta për zhvillimin e demokracisë, për rritjen e sigurisë dhe të nivelit ekonomik të rajonit. Efekt i padiskutueshëm është fakti që Pakti ka rritur interesin dhe vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar ndaj rajonit të Ballkanit dhe, në të njëjtën kohë, ka rritur nivelin e incentivat e vetë vendeve të rajonit për të përmbushur kërkesat dhe për të intensifikuar procesin e reformave. Një network iniciativash rajonale të përbashkëta ka marrë udhë për integrimin e rajonit. Produkti më sinjifikativ i këtyre dy vjetëve të ekzistencës së paktit

është Memorandumi i Liberalizimit të Tregtisë midis vendeve të rajonit, firmosur më 27 qershor 2001, në Bruksel nga ministrat e tregtisë së vendeve të rajonit. Në vazhden e kësaj iniciative janë edhe marrëveshjet e tregtisë së lirë, që Shqipëria po negocion me vendet e rajonit. Ne jemi në përfundim të negociatave për një marrëveshje të tregtisë së lirë me Maqedoninë dhe, së shpejti, do të fillojmë bisedimet me Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë, Bosnje Hercegovinën dhe me vendet e tjera nënshkruese të memorandumit.

Ky memorandum, sanksionon masat prioritare që do të hedhin bazat për krijimin e një zonë të lirë tregtare për rajonin. Një ndryshim cilësor historik - që për shumë vetë mund të dukej i pamundur deri edhe para dy vjetësh në kohën e krizës kosovare - tashmë ka ndodhur. Në një periudhë të shkurtër rajoni do të shndërrohet në një zonë të lirë ekonomike.

Rritja e marrëdhënieve tregtare me vendet fqinje dhe arritja e lehtësimit dhe e liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë në rajon, do të realizohet paralelisht me hapat e ndërmarrë në procesin e Stabilizim Asocimit. Ky fakt, na jep mundësinë të përballojmë sfidat e ardhshme, angazhimet tona në kuadrin e Paktit të Stabilitetit, dhe më së fundi negocimin për Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me Bashkimin Europian në dhe me vendet e rajonit. Në këtë kuadër, politikatat afatshkurtra e afatgjata do të fokusohen në lidhje me:

- marrjen e një sërë masave për të përparuar në liberalizimin dhe në lehtësimin e tregtisë në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore;
- rritjen e shpejtë të volumit të tregtisë ndërkombëtare;
- përmirësimin e lidhjeve tregtare me rajonin nëpërmjet reduktimeve tarifore ; dhe
- eliminimin e barrierave në tregti;

duke përmirësuar në këtë mënyrë kapacitetin absorbues të vendit në drejtim të tërheqjes së kapitaleve dhe të investimeve të huaja direkte. Të gjitha këto masa, dëshmojnë një fillim të suksesshëm për të zhvilluar më tej negociatat midis nesh, me qëllim që marrëveshjet e tregtisë së lirë, në këtë kuadër, të shndërrohen në një sistem eficient për të gjithë aktorët e Europës Juglindore.

Paralelisht, po punohet për bashkimin e arterieve të infrastrukturës së rajonit mbi bazën e strategjive rajonale të infrastrukturës që përcaktojnë rrjetet kryesore të zhvillimit të infrastrukturës së rajonit dhe integrimin e tyre me rrjetet europiane të infrastrukturës. Pa dyshim, që Porti i Durrësit mbetet një nga portat kryesore hyrëse të rajonit, fakt që, gjithmonë e më shumë, e ka sjellë këtë port në

vëmendjen dhe në financimet e komunitetit ndërkombëtar. Para disa javëve, BEI konfirmoi edhe një paketë tjetër prej 45 milionë eurosh, për rikonstruktimin e këtij porti.

Konferenca e Donatorëve, e mbajtur në Bruksel, në 30 mars të vitit 2000, miratoi paketën financiare "Quick Start" që do të financonte projektet në kuadër të Paktit të Stabilitetit për një fazë njëvjeçare. Paketa përfshinte 244 projekte me një vlerë mbi 2,4 miliardë euro. Paketa "Quick Start" ishte ndoshta paketa më e madhe e mobilizuar nga komuniteti i donatorëve, parametrat kohorë të implementimit të së cilës, në raport me numrin dhe kompleksitetin e projekteve, ishin në nivele rekord. Nga paketa "Quick Start", Shqipëria përfiton nga projekte (të drejtpërdrejta për Shqipërinë apo me shtrirje rajonale) në të tri tryezat që kapin shumën rreth 170 milionë euro, nga të cilat 136 milionë euro janë për projekte të infrastrukturës.

Konferenca e Dytë Rajonale e Paktit, e mbajtur në Bukuresht në fund të muajit tetor, konfirmoi angazhimin e Komunitetit të Donatorëve për projekte të rajonit që kapin shumën totale mbi 2,3 miliardë euro. Projektet shqiptare janë rreth 304 milionë euro dhe mbështesin kryesisht sektorët e infrastrukturës, ku vendin primar e zë sektori i energjitikës.

KONKLUZIONE

Si konkluzion do të përmendja, se Shqipëria tashmë është larguar shumë nga pikënisja e saj drejt Europës, dhjetë vjet më parë. Procesi i Stabilizim Asocimit ka filluar tashmë edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ballkani, gradualisht, po kthehet në një rajon ku stabiliteti nuk ka më trajtë virtuale, por është një realitet sa i dëshirueshëm aq edhe i mundshëm.

Faktori vendimtar për shpejtësinë dhe largësinë e procesit të Stabilizim Asocimit jemi vetë ne, përkushtimi, përgjegjshmëria, largpamësia e vizionit dhe e kompromiseve tona. Në këtë rrugë mbështetemi nga një popull vital, që na ka besuar motorin e procesit dhe nga partnerë potencialë, që na ofrojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen e nevojshme. Nuk mund të pohoj se në këta dhjetë vjet kemi bërë gjithçka mirë, aq më pak mund të them se çfarë do të bëjmë më tej do të jetë perfekte. Por, ajo që mund të them me bindje është që jemi në rrugën e duhur dhe duhet të vazhdojmë çfarë kemi nisur në shërbim të një populli, që meriton më shumë dhe që ka humbur shumë kohë. Çështja nuk është nëse kemi një strategji të mirë apo një plan veprimesh të detajuar se

Ç'duhet të bëjmë, çështja është nëse kemi vullnetin politik dhe vendosmërinë për t'u bashkuar me atë pjesë të kontinentit, të cilës i përkasim. Neve - të gjithëve së bashku - na është dhënë shansi historik t'i sjellim këtij vendi një ndryshim cilësor - parametrat europianë të standardeve të jetesës. Fillimi i bisedimeve për Marrëveshjen e Asocimit nuk përbën përmbushjen e objektivit tonë, përkundrazi jemi shumë larg prej tij, por tashmë jemi të ndërgjegjshëm se e ardhmja europiane e Shqipërisë dhe e shqiptarëve - nuk është objektiv i pamundur.

Do të doja për një çast të kthehesha në kohë dhjetë vjet më parë, në kronikën televizive për shkollën malore, ku po shpërndareshin ndihma ushqimore për fëmijët. Të gjithë mund të bëjmë të mundur, që fëmijët e atyre që para dhjetë vjetëve jetonin me ndihma ushqimore, të lindin si qytetarë europianë, me një standard jetese e perspektivë të ndryshme nga prindërit e tyre.